

ODA E HOTELIERISË
DHE TURIZMIT TË KOSOVËS
THE CHAMBER OF HOSPITALITY AND TOURISM OF KOSOVO

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NDËRMJET:

ODA E HOTELIERISË DHE TURIZMIT TË KOSOVËS
OHTK
PRISHTINË
Nr. 00097 dt. 15.4.2024

UNIVERSITETIT “HAXHI ZEKA”, ME SELI NË PEJË, RR. UÇK-SË, P.N., 30000

DHE

ODA E HOTELIERISË DHE TURIZMIT TË KOSOVËS, ADRESA LAKRISHTË LLAMELLA III,
PRISHTINË, REPUBLIKA E KOSOVËS

PALËT NËNSHKRUESE TË KËTIJ MEMORANDUMI DAKORDOHEN SI NË VIJIM:

Oda e Hotelierisë dhe Turizmit të Kosovës dhe Universiteti “Haxhi Zeka” pajtohen të nënshkruajnë këtë memorandum bashkëpunimi me qëllim të shtrirjes dhe zgjerimit të veprimtarisë së përbashkët, zgjerimit të mundësive për projekte të përbashkëta të ndihmës reciproke për promovimin e vlerave të përbashkëta e në theks të veçantë inkurajimin e nismave me qëllim të aftësisimit të nxënësve që njohurit e tyre teorike t’i përdorin edhe në praktikë.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e bashkëpunimit të ndërsjellët palët nënshkruajnë këtë memorandum bashkëpunimi me përmbajtjen e mëposhtme:

Qëllim

Qëllim kryesor i këtij Memorandumi është koordinimi i veprimeve dhe thellimi i bashkëpunimit në mes të Odës së Hotelierisë dhe Turizmit të Kosovës dhe Universitetit “Haxhi Zeka” për arritjen e objektivave të përbashkëta e në theks të veçantë bashkëpunimi për realizimin e projekteve që synojnë lidhjen e mësim-nxënies teorike me punën praktike për të arritur kështu një progres më të madh ekonomik në vendin tonë dhe përgatitjen e nxënësve për tregun brendshëm dhe atë të jashtëm të punës.

Objektivat

1. Palët si objektiv themelor kanë promovimin, zhvillimin ekonomik, akademik dhe social të rajonit.
2. Diskutime dhe shtjellimi i temave të ndryshme dhe marrja e hapave konkret në drejtim të përgatitjes së studentëve si nga aspekti teorik ashtu edhe nga ai praktik.

3. Nisma të përbashkëta që studentëve t'u mundësohet kryerja e punës praktike nëpër kompanitë hoteliere të cilat janë anëtare të OHTK-së
4. Palët synojnë të promovojnë bashkëpunimin mes Universitetit "Haxhi Zeka" dhe Odës së Hotelierisë dhe Turizmit të Kosovës, për të identifikuar dhe zhvilluar projekte, panairë, trajnime, programe dhe inovacione që kontribuojnë në rritjen ekonomike dhe akademike të rajonit.
5. Organizimi i trajnimeve të përbashkëta me qëllim të ngritjes profesionale të studentëve
6. Nxitja e dialogut ndër rajonal me qëllim promovimin e politikave ekonomike, vlerave sociale, politike dhe kulturore;
7. Bashkëpunimi rajonal në drejtim të koordinimit të projekteve investive me interes për rajonin e më gjerë;
8. Palët zotohen së do të japin kontributin e tyre maksimal për realizimin e nismave të përbashkëta që kanë synim kryesor aftësimin e studentëve në aspektin praktik dhe përgatitjen e tyre për tregun e punë.
9. Organizimi i Forumit ekonomike, sociale, akademike, biznesore, politike me partneritet publiko-privat;
10. Ofrimi dhe avancimi i ideve novatore që çojnë në hartimin e projekteve investive, me synim përfshirjen dhe mobilizimin e kapitalit të diasporës dhe me gjerë.
11. Inkurajimi dhe nxitja e investimeve të huaja direkte dhe përmirësimi i klimës për të bërë biznes në regjionin e dukagjinit dhe me gjerë.
12. Aplikimin e përbashkët dhe hartimin e projekteve për zhvillim ekonomik të rajonit në organizata, institucione, lokale, rajonale dhe ndërkombëtare etj.

Detyrat dhe përgjegjësitë e palëve

1. Oda e Hotelierisë dhe Turizmit të Kosovës zotohet se do të bashkëpunoj sinqerisht me Universitetin "Haxhi Zeka" duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë dhe resurset e saja njerëzore për jetësimin e qëllimeve të përbashkëta.
2. OHTK-ja do të shfrytëzoj dhe do të vë në dispozicion të gjitha kapacitetet e veta me qëllim të realizimit të detyrave dhe përgjegjësiave që dalin nga nënshkrimi i këtij memorandum.
3. Universiteti "Haxhi Zeka" do të jap kontributin e tij maksimal duke vënë në shërbim të realizimit të projekteve, ideve dhe qëllimeve të përbashkëta gjithë potencialin njerëzor.
4. Universiteti "Haxhi Zeka" do t'i pranoj dhe do të shkëmbej me përfaqësuesit e OHTK-së, përvojat më të mira nga aktivitetet e mëparshme të natyrës së njëjtë.
5. Palët do të bashkëpunojnë dhe do të zhvillojnë aktivitete e takime të përbashkëta, nëpërmjet të përfaqësuesve të deleguar, të cilët do të krijojnë grupe punuese.
6. Përfaqësuesit e dërguar nga palët janë të obliguar që për rrjedhën e aktiviteteve dhe rezultatet e projekteve të punojnë raporte të rregullta dhe të njëjtat t'i prezantojnë para organeve udhëheqëse të institucionit që i ka deleguar.
7. Palët, nëpërmjet të përfaqësuesve të tyre do të zhvillojnë aktivitete të përbashkëta dhe do të koordinojnë të gjithë hapat më qëllim të realizimit sa më të suksesshëm të synimeve të përbashkët.
8. Palët zotohen se do të sigurojnë lidhjen në mes të nxënësve dhe kompanive turistike dhe hoteliere që janë anëtare të OHTK-së.

Konfidencialiteti i të dhënave

1. Të dyja palët janë të obliguara që të mbajnë konfidencial çdo informacion që është miratuar në këtë Memorandum dhe nëse është paraqitur në mbështetje të qëllimit për të cilin është bërë kërkesa.
2. Të gjitha informacionet e miratuara sipas këtij Memorandumi janë konfidenciale dhe nuk mund të zbulohen nga njëra palë pa pëlqimin e palës tjetër.

Zbatimi

1. Palët përcjellin mënyrën e jetësimit të këtij memorandumi nga ana e përfaqësuesve të tyre.
2. Palët mund të japin udhëzime dhe direktiva se cilat veprime duhet marrë për implementimin e projekteve dhe kryerjen e obligimeve deri në realizimin e qëllimeve të përbashkëta.

Përfaqësimi i palëve

Secila palë përfaqësohet nga njerëzit e tyre të deleguar nga ta me autorizim në formë të shkruar.

Ndërprerja e memorandumit dhe rrethanat e paparashikuara

1. Ndërprerja e Memorandumit të bashkëpunimit bëhet me marrëveshje miqësore ndërmjet palëve.
2. Nëse implementimi duhet të ndërpritet për shkak të rrethanave të krijuara nga fuqitë madhore (vis maior) apo rrethanave tjera të paparashikuara, palët me marrëveshje do të vendosin për veprimet që do të ndërmarrin lidhur me memorandumin.

Amandamentimi

1. Memorandumi mund të ndryshohet vetëm me miratimin unanim të të dyja palëve.
2. Ky Memorandum mund të ndryshohet ose plotësohet në çdo kohë nga palët me marrëveshje me shkrim.
3. Çfarëdo kushti i caktuar që nuk është precizuar në këtë Memorandum, për të cilin palët pajtohen për t'u integruar në tekstin e tij apo për t'a plotësuar atë si amandament të nënshkruar nga palët do të konsiderohet si pjesë integrale e këtij dokumenti.

Kohëzgjatja (afati i realizimit) dhe zgjidhja në rast të mosmarrëveshjeve

1. Kohëzgjatja e këtij Memorandumi është në vullnetin e lirë të palëve sipas vlerësimit të tyre diskrecional.
2. Ky memorandum bashkëpunimi lidhet nga palët pa ndonjë afat të caktuar dhe është i vlefshëm për sa kohë palët kanë interes të përbashkët.
3. Palët do të mundohen që paqartësitë dhe mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin e këtij Memorandumi t'i zgjedhin në mënyrë miqësore dhe me bisedime.
4. Përfundimi i këtij Memorandumi në rast të mosmarrëveshjeve në mes palëve nuk krijon ndonjë obligim ligjor për asnjërën prej tyre.

Efektet e përfundimit të memorandumit në mënyrë të njëanshme

1. Ky Memorandum do të mbetet në fuqi derisa njëra nga palët të njoftojë palën tjetër me shkrim se do të rishikojë, ndryshojë apo edhe të tërhiqet nga Memorandumi. Secila palë mund të përfundojë këtë Memorandum duke njoftuar me shkrim palën tjetër.
2. Memorandumi do të quhet i përfunduar ditën kur pala ta ketë marrë njoftimin me shkrim për tërheqjen e palës tjetër nga Memorandumi.
3. Ndërprerja me vullnet të njëanshëm e Memorandumit nuk krijon pasoja juridike për asnjërën nga palët nënshkruese.
4. Pala që është tërhequr me vullnet të njëanshëm nga Memorandumi është e obliguar që t'i ofrojë palës tjetër të gjitha të dhënat që i ka në dispozicion e që lidhen me realizimin e memorandumit.
5. Të dyja palët janë të obliguara që edhe pas përfundimit të Memorandumit të vazhdojnë të ruajnë të dhënat konfidenciale nëse ka të tilla.

Hyrja në fuqi

1. Ky memorandum hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga përfaqësuesit e palëve.
2. Ky Memorandum përgatitet dhe nënshkruhet në 2 (dy) kopje identike, në gjuhën shqipe.


Oda e Hotelierisë dhe Turizmit të Kosovës

Dr. Sc. Hysen SOGOJEVA



Universiteti "Haxhi Zeka"

Prof. Dr. Armand KRASNIQI



Pejë, më 15.04.2024

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË	UNIVERSITETI UNIVERSITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI		
Nr. / Br. / No. <u>990</u>	Nr. i faq/ Br. str / 'to. pg <u>4</u>	
Data / Datum / Date: <u>15.04.2024</u> Pejë / Pojë		